REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 308/20
Datë/Datum. 18.05.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *(Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës)*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *(00220-20-331-1-1-1)*

Sa i përket tenderit për *(Furnizim me barna nga LE për nevojat e SHSKUK-së – LOT 33)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

MATKOS PHARM SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr.Shpëtim Rrobaj, Nr. 289, Prishtinë
(Adresa)

Prishtinë *(Vendi)*

10 000 *(Kodi postar)*

049-159-159 *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

LIMAN BUZOKU
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Adresa elektronike)

SH.P.K. MatkosPharm PRISHTINË

15.05.2020 *(Data e parashtrimit të ankesës)*

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me 13.02.2020 *Vendimi për pezullim me 23.03.2020* *Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderëve 07.04.2020 – LOT 33* *Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar* *Ankesa (Kërkesa për rishqyrtim) pranë AK-së me datë 08.05.2020* *Vendim – Kërkesa për rishqyrtim refuzohet me 12.05.2020* *Njoftimi për Dhënie të Kontratës me 14.02.2020*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ PO **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

SH. P. K. MatkosPharm PRISHTINË

Po [PO] Jo [ ]

Me datë 08.05.2020 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Në këtë kërkesë kemi paraqitur faktin se tek detajet e tenderit ku figurojnë të gjitha kërkesat për sqarime shtesë, proces verbali i paraqitur me datë 26.03.2020, pas të cilit figuron vendimi i autoritetit kontraktues. Ku kësaj kërkesë i ishte bashkangjitur edhe dëshmia se si paraqitet në platformën e e-Prokurimit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1
Neni 6
Neni 59
Neni 60

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti kontraktues me datë 07.04.2020 kishte kërkuar sqarime shtesë përmes "Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit". Mirëpo, këtë kërkesë e ka ngarkuar jo në faqen apo vendin për këtë aktivitetit të prokurimit por në një vend krejt tjetër. Si pasojë e mos ngarkesës së kërkesës për sqarime shtesë në vendin e duhur nga AK, për neve ka qenë e pamundur që të gjejmë një kërkesë të tillë sepse ne e kemi përcjellur çdo kërkesë të AK-së pranë vendit përkatës dhe jo krejt diku tjetër. Pra, mos përgjigja nga OE "Matkos Pharm" në kërkesën për sqarime shtesë ka ndodhur për shkak të gabimit të AK-SË gjatë ngarkimit të këtij dokumenti në vendin e gabuar nga autoriteti kontraktues. Andaj, mos ngarkimi në vendin e duhur i kërkesës për sqarime shtesë është në kundërshtim me qëllimi e ligjit të LPP-së, konkretisht në kundërshtim me nenin 1 sepse qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. Po ashtu, është në kundërshtim me par. 2 të nenit 1 të LPP-së ku kërkohet që të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës. Ndërsa, dokumenti i ngarkuar në vendin e gabuar paraqet shkallë të lartë të jo transparencës dhe diskriminimit.

SH. P. K. MatkosPharm PRISHTINË

Po ashtu, vlen të ceket se oferta jonë është më e lirë në shumë prej 18,200.00 euro në krahasim me OE të rekomanduar për kontratë. Në e kuptojmë që secili OE i rekomanduar për kontratë duhet ti plotësoj kërkesat e dosjes së tenderit dhe AK duhet të shpërblej tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Megjithatë, për shkak të përdorimit të gabuar të platformës së e-prokurimit nga ana e AK-së nuk do të thotë se na bënë OE të papërgjegjshëm. Si pasojë e këtij veprimi, AK detyrimisht shkel nenin 6 të LPP-së, ku secili autoritet kontraktues është i obliguar që të siguroj që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike. Përkundrazi, AK e shpërblen me kontratë operatorin ekonomik me çmim më të shtrenjtë prej 18,200.00 euro.

Gjithashtu, edhe rezultatin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve e përcakton mënyra e ngarkimi (publikimit) të kërkesës së AK-së për sqarimin e tenderëve sepse si pasojë e publikimit të gabuar të kësaj kërkese rezulton me shkelje të nenit 59 të LPP-së gjatë vlerësimit të tenderëve si dhe kriterit të dosjes së tenderit "çmimi më i ultë" në lidhje me nenin 60 të LPP-së.

Andaj, kërkojmë nga OSHP që të trajtoj me kujdes mënyrën e komunikimit të AK-së me rastin publikimit të letrës standarde për sqarime shtesë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmi i shkaktuar material është përgatitja për këtë aktivitet të prokurimit, ku përfshihen koha e personelit për përgatitje të ofertës, shpenzime të materialit punues, përpilimi i ankesës së parashtruar pranë OSHP-së, etj.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë";*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës";*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ ;*
d) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
e) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-së;*
f) *Dëshmi se tek të dhënat e tenderit nuk ekziston kërkesa e AK "Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderëve 07.04.2020 – LOT 33"*
g) *Dëshmi se kërkesa e AK "Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderëve 07.04.2020 – LOT 33" është ngarkuar në vendin e gabuar;*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

SH. P. R. MatkosPharm PRISHTINË